



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 6.1.2023

Nr: 1

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**ADMINISTRIMIN E KËRKESAVE ANKIMORE NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE DHE
REGJISTRIMIN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 127, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 11, të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S :

1. Kërkesa ankimore regjistrohet në regjistrin e protokollit, nga nëpunësi përgjegjës për protokollin, menjëherë sapo ajo mbërrin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Mbi dokumentin e kërkesës ankimore nëpunësi përkatës i protokollit shënon datën dhe numrin e protokollit të radhës, sipas regjistrimit të protokollit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe orën e mbërritjes së kërkesës ankimore.
2. Pasi protokollohet kërkesa ankimore, përcillet menjëherë tek Drejtoria e Ligjshmërisë, e cila është përgjegjëse për mbajtjen dhe administrimin e Regjistrimit të Ankesave. Subjektit ankues i jepet një vërtetim mbi dorëzimin e ankimit, sipas modelit në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Data: 6.1.2023 Nr: 1
Ora: 12:00



“Për administrimin e kërkesave ankimore në
KQZ dhe regjistrimin e tyre”

3. Drejtoria e Ligjshmërisë regjistron kërkesën ankimore në Regjistrin e Kërkesave Ankimore, sipas modelit në lidhjen nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Regjistri i Kërkesave Ankimore përmban numrin dhe datën e regjistrimit të kërkesës ankimore. Gjithashtu, në Regjistër shënohen numri, data dhe ora e prokollimit të kërkesës ankimore.
5. Regjistrimi i kërkesave ankimore në Regjistër fillon me numrin 1, e mbyllet me numrin që i korrespondon kërkesës së fundit ankimore të regjistruar, jo më vonë se 24 (njëzetë e katër) orë nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve pararendëse.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

LIDHJA 1

VËRTETIM

Sot, më datë __.__.____, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është depozituar Kërkesa Ankimore nr. _____, datë __.__.____, nga _____

Kërkesa Ankimore u mor në dorëzim nga:

Sektori i Protokollit dhe Arkivës në KQZ

(emër, mbiemër, firmë)

